

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për studime në shkollat e larta ushtarake të Greqisë, **7 (shtatë)** të drejta studimi si më poshtë vijon:

1. Shkolla e studentëve për oficerë të Forcës Tokësore (Evelpidon) 1 (një) kuotë.
2. Shkolla e studentëve për oficerë të Forcës Detare (SND) 1 (një) kuotë.
3. Shkolla e studentëve për Oficerë të Shërbimeve të Forcave të Armatosurave (SASS).
 - Specialiteti “Mjekësi” 2 (dy) kuota
 - Specialiteti “Psikologji” 1 (një) kuotë
 - Specialiteti “Ekonomi” 1 (një) kuotë
 - Specialiteti “Drejtësi” 1 (një) kuotë

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 08 gusht 2025.

1. Kriteret e pranimit të kandidatëve:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale.
- Të mos jetë në ndjekje penale.
- Të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata.
- Të mos ketë probleme me deportimin.
- Të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera.
- Të mos jetë person i dyshuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale.
- Të jetë i moshës jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 24 vjeç , në ditën e fillimit të vitit akademik.
- Të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë, me notë mesatare jo më pak se **7 (shtatë)**.
- Të mos jetë i martuar, i fejuar, i ve ose të mos bashkëjetojë.
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore.
- Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen, të mos ketë tatuazhe ne pjesët e trupit, të mos jetë dyz taban, të mos ketë në trup plagë apo shenja djegie, të jetë me flokë dhe të mos ketë sëmundje të lëkurës, si dhe të ketë bërë të gjitha vaksinat dhe të mos jetë mbartës i sëmundjeve ngjitëse.

- Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe jo më pak se 160 cm për femrat.
- Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme) të tjera; të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike.
- Të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhësore ose trajnuese, që zhvillohen nga vendet partnere në vendin tonë ose pranë shkollave ushtarake jashtë vendit, me qëllim pranimin në shkolla ushtarake.
- Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit.
- Të plotësojë kushtin e sigurisë.
- Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor në Njësinë Mjekësore Ushtarake.
- Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se:
 - a. Kanë kryer më parë të njëjtin nivel arsimor ushtarak brenda ose jashtë vendit.
 - b. Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar ato.
- Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet.

2. Procedurat e aplikimit

Kërkesën për të marrë pjesë në konkurrim, kandidatët aplikojnë: online, në postë, në zyrat e rekrutimit në qarqe, si dhe pranë Qendrës së Personel Rekrutimit. Kërkesa do të bëhet sipas modaliteteve të trajtuara në aneksin A.

3. Dokumentet për regjistrim:

3.1 Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimiit Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Në fazën e regjistrimit

- Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve në Akademitë Ushtarake të Greqisë dhe preferenca e degës për të cilën aplikohet.
- Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, **Aneksi A**.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit
- Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave.
- Fotografi për dokument (4x6), 2 (dy) copë.
- formular i vetëdeklarimit për gjendjen shëndetësore;

- formularin e vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
- formularin e kushtit të sigurisë;
- Raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit i shoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndët narkotike, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë.
- Analizat e urinës për përdorimin e lëndëve narkotike.
- Analizat e gjakut komplet, glicemi, kreatinemia, transamina (SGPT-SGOT), birlirubina totale dhe e fraksionuar, G6PDH9 metoda kuantitative).

b) Në përfundim të testimit ;

Kandidatët që janë kualifikuar në testimet e zhvilluara, brenda **10 ditëve** duhet të paraqesin dukumentacionin e mëposhtëm:

- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- vërtetim nga përmbartimi;
- raportin mjekësor i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor i NJMU.

3.2 Qendra e Personel Rekrutimit të sigurojë dukumentacionin, i cili mund të shkarkohet online nëpërmjet portalit qeveritar “e-albania”, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3.3 Kandidatët të sigurojnë vetë dukumentacionin e kërkuar në rastet kur për arsye teknike ai nuk mund të shkarkohet nëpërmjet portalit nga QPR-ja.

4 Datat e testimeve:

Testi Fizik	:	11.08.2025
Testi Intelektual	:	11.08.2025
Testi gjuhës së huaj (Anglisht)	:	12.08.2025
Testi Psikologjik	:	12.08.2025

5.Të dhënat tabelore të Testimit të Aftësive Fizike:

Kandidatët e për zgjedhur që konkurrojnë për akademinë Detare të Greqisë duhet të kenë si aftësi notin.

Meshkuj		Femra		Meshkuj		Femra		Meshkuj		Femra	
Pompa	Pikët	Pompa	Pikët	Palosje/ Shpalosje	Pikët	Palosje/ Shpalosje	Pikët	1000 m, minuta	Pikët	1000 m, minuta	Pikët
57		34		70		64		3'19"		3'34"	
58	100	33	100	71	100	65	100	3'20"	100	3'35"	100
57	99	32	98	70	99	64	99	3'21"	99	3'36"	99
56	98	31	96	69	98	63	98	3'22"	98	3'37"	98
55	97	30	94	68	97	62	97	3'23"	97	3'38"	97
54	96	29	92	67	96	61	96	3'24"	96	3'39"	96
53	95	28	90	66	95	60	95	3'25"	95	3'40"	95
52	94	27	88	65	94	59	94	3'26"	94	3'41"	94
51	93	26	86	64	93	58	93	3'27"	93	3'42"	93
50	92	25	84	63	92	57	92	3'28"	92	3'43"	92
49	91	24	82	62	91	56	91	3'29"	91	3'44"	91
48	90	23	80	61	90	55	90	3'30"	90	3'45"	90
47	89	22	78	60	89	54	89	3'31"	89	3'46"	89
46	88	21	76	59	88	53	88	3'32"	88	3'47"	88
45	87	20	74	58	87	52	87	3'33"	87	3'48"	87
44	86	19	72	57	86	51	86	3'34"	86	3'49"	86
43	85	18	70	56	85	50	85	3'35"	85	3'50"	85
42	84	17	68	55	84	49	84	3'36"	84	3'51"	84
41	83	16	66	54	83	48	83	3'37"	83	3'52"	83
40	82	15	64	53	82	47	82	3'38"	82	3'53"	82
39	81	14	62	52	81	46	81	3'39"	81	3'54"	81
38	80	13	60	51	80	45	80	3'40"	80	3'55"	80
37	79	12	59	50	79	44	79	3'41"	79	3'56"	79
36	78	11	58	49	78	43	78	3'42"	78	3'57"	78
35	77	10	57	48	77	42	77	3'43"	77	3'58"	77
34	76	9	56	47	76	41	76	3'44"	76	3'59"	76
33	75	8	55	46	75	40	75	3'45"	75	4'00"	75
32	74	7	54	45	74	39	74	3'46"	74	4'01"	74
31	73	6	53	44	73	38	73	3'47"	73	4'02"	73
30	72	5	52	43	72	37	72	3'48"	72	4'03"	72
29	71	4	51	42	71	36	71	3'49"	71	4'04"	71
28	70	3	50	41	70	35	70	3'50"	70	4'05"	70
27	69	2	49	40	69	34	69	3'51"	69	4'06"	69
26	68	1	48	39	68	33	68	3'52"	68	4'07"	68
25	67			38	67	32	67	3'53"	67	4'08"	67
24	66			37	66	31	66	3'54"	66	4'09"	66
23	65			36	65	30	65	3'55"	65	4'10"	65
22	64			35	64	29	64	3'56"	64	4'11"	64
21	63			34	63	28	63	3'57"	63	4'12"	63
20	62			33	62	27	62	3'58"	62	4'13"	62
19	61			32	61	26	61	3'59"	61	4'14"	61
18	60			31	60	25	60	4'00"	60	4'15"	60

QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT